



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 32-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.02.2021, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Naim Jahiri
3. Lulzim Rustemi
4. Egzona Fazlija
5. Naxhije Gashi
6. Arben Salihu
7. Slavisa Trajkovic
8. Zoran Çirković
9. Franjo Goleme

Të tjerë prezent

1. Shfaqet Amerllau, DB
2. Bekim Zaskoku
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Merita Bytyqi**,

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 31-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informatë nga Drejtorati për Bujqësi rreth subvencioneve në Bujqësi
3. Informatë nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, rreth mundësisë së subvencioneve në kulturë rini dhe sport.
4. Të ndryshme

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 31-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 31-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 31-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Informatë nga Drejtorati për Bujqësi rreth subvencioneve në Bujqësi

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, i dha fjalën Shefqet Amerllahu, drejtor i DB i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Zoran Cirokovic, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se kam një pyetje, dëshiroj të di se cilat rrugë do të shtrohen në Grackë dhe a do të përfundojnë këtë vit?

Rasim Hasani projekti është dy vjeçar por operatori na ka premtu që do ta përfundojë projektin këtë vit, ndërsa pagesa do të realizohet vitin e ardhshëm.

Sllavisha Trajkovic pasi që i përshëndeti të pranishmit, pyetje konkrete është projekti i lumit Janjevka deri ku do të shkojë dhe kompania e cila po punon a duhet ti i largoj mbeturinat prej lumit.

Lulzim Rustemi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se kam disa pyetje, Lumi Janjevka ku fillon dhe ku përfundon ky projekt dhe a do të punohet me gur sikurse në Konjuh.

Rruga Marie Shllaku a vazhdon deri te Rufci, shtigjet e ecjeve ka janë të planifikuara. Rrjeti i ujësjellësit për fshatrat Kraishtë Ribar etj a ka burime të reja të ujit apo shfrytëzohen ato ekzistuese.

Naim Jahiri, pasi i përshëndeti të pranishmit, e falënderoj drejtorin për prezencën e tij. Pyetja ime është për kanalizimin në fshatin Slllovi, janë disa banorë të cilët ende nuk janë kyç dhe është mirë të dilet së bashku me inspektorët me qëllim të detyrimit për lidhje në kanalizim, sepse ende vazhdon derdhja e kanalizimit në lum.

Rruga Afrim Zhitia a do të jetë në projekt këtë vit. Për fshatin Brus a ka të planifikuar ndonjë projekt.

Franjo Goleme, pasi i përshëndeti të pranishmit pyeti drejtorin se a ka mundësi që rruga Janjevë Bukovicë të ndërtohet ose të paktën të zhavorrohet sepse momentalisht është e pa kalueshme ajo rrugë.

Skender Bikliqi, edhe unë po ndërlidhem me parafolësit dhe po theksoj se bashkëpunimi mes komunës dhe përfaqësuesve të fshatit duhet të jetë më i mirë sepse shumicën e rasteve kur ka bashkëpunim sukseset nuk mungojnë, në të kundërtën projektet nuk po zbatohen si duhet. Ka disa familje të cilat nuk janë kyçur fare në kanalizim gjithashtu disa rrugica kanë mbet ende pa u përfunduar.

Rasim Hasani, pasi i përshëndeti të pranishmit ju përgjigj pyetjeve të anëtarëve edhe pse kemi vështirësi për shkak të pandemisë thuajse të gjitha projektet e parapame janë duke u implementuar në teren.

Lumi janjevka do të vazhdoj deri te derdhja në lumin Sitnica, të gjitha mbeturinat kompania do të jetë e detyruar ti largoj. Shtegu i ecjes do të vazhdoj deri te rruga transit Ibrahim Rugova deri te bankinat e lumit Sitnica dhe do të përfundoj te shtegu ekzistues te ETC ja. Për kanalizimin në Sllovi do të flas me drejtorin e inspektoratit dhe do të dalim në teren ta shikojmë gjendjen. Ruga për Bukovicë do të shohim mundësinë se çka mund të bëjmë.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, u kalua në pikën e radhës.

III

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, për shkak të problemet shëndetësor Shefja e ZLK-s nuk gjenet në punë dhe për këtë pikë do të raportohet në mbledhjen e radhës.

Pasataj kësaj pike u kalua në pikën të ndryshme

IV

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, tha se a ka dikush të diskutoj rreth kësaj pike.

Sllavisha Trajkovic, kam disa çështje për ti ngritur, e para sa i përket dëmtimit të varrezave kemi pas premtime për rregullimin e varrezave por për shkak të Pandemisë nuk e di se çka ka ndodhë, përveç OSBE-ja e cila i ka bërë vendosjen e kamerave.

Dhe çështja e fundit ka të bëjë rreth mjeteve financiare me rastin e vdekjes së anëtarëve të familjes?

Çështja e dytë ne se bashku me iniciativën e qytetarëve i kemi pastrua varrezat por nuk po kemi ku ti dërgojmë ato mbetjet gjatë pastrimit?

Radimilla Simionovic, une kam qenë prezent gjatë takimit lidhur me varrezat dhe shpresojmë që pas pandemisë të fillojnë të realizohet pretimet.

Lulzim Rrustemi, kam një kërkesë që të mbahen dy mbledhje dhe të shkojmë sipas planit të punës pasi që qe korniza afatmesme buxhetore do të diskutohet ne kuvend në seancën e ardhshme dhe ne në komitet nuk po mundemi ta diskutojmë.

Naim Jahiri, edhe unë pajtohem me Lulin që të ketë nga dy mbledhje dhe të shkojmë sipas planit të punës.

Skender Bikliqi, une kam qenë te kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi kemi diskutuar dhe e kemi lanë me u taku javën e ardhshme me diskutu prap po ashtu kam qenë te sektori i kuvendit të cilët çdo herë me kanë ndihmuar dhe me kanë dhënë kurajë qe unë të vazhdoj të punoj edhe më shumë i gjithë sektori po në veçanti Naseri Behari.

Naim Jahiri e përgëzoj Feratin për iniciativën qe kanë marrë për blerje e një parcele për varreza, kërkesë e tij ka qenë zhavorrimi i rrugës deri te varrezat po ashtu te ketë edhe rrethojë të varrezave.

Franjo Goleme, ne Janjevë ka filluar shpërndarja e shportave të mbeturinave po ashtu janë shtuar edhe dy rrugica edhe na ndryshuar jeta e qytetarëve për të mirë.

Kam një kërkesë rreth për një familje e cila ka qenë në Zvicër e cila është kthyer në Janjevë ,i është premtuar për shtëpi po ende asgjë nuk është realizuar.

Po ashtu edhe një e moshuar jeton në një shtëpi e cila nuk i plotëson kushtet?

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14³⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi